REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ...59..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30/ 10 / 2026

VENDIM

Nr. 3 datë 30 / 10 / 2026

PËR

PROJEKTIN "REHABILITIMI I DIGES SË TURANIT, BASHKIA TEPELENË"

Në mbështetje te Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 30.10.2026 mori në shqyrtim Projekt zbatimin e paraqitur nga Bashkia Tepelenë për projektin "Rehabilitimin e diges së Turanit". Projekti është pregatitur nga firma konsulente "SIRE-ALB"sh.p.k e dorëzuar në SKDM nga Bashkia Tepelenë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur me (CD) rezulton se projekti nuk ka plotësuar kërkesat e legjislacionit përkatës. Në material nuk paraqiten llogaritjet e filtrimit dhe të faktorëve të sigurisë së skarpatave, verifikimi i qëndrueshmërisë në zonat ku janë konstatuar deformime dhe erozion, detajimi i plotë teknik për riparimin e ujëlëshuesit, projektet e paraqitura nuk janë të plota për riparimin e digës si dhe vënien ne funksion të plotë të digës dhe rezervuarit të Turanit.

Projekti nuk është i shoqëruar **nga detyra e projektimit dhe oponenca teknike, ku është një domosdoshmeri paraqitja e tyre, theksojmë që projekti duhet të sillet zyrtarisht i printuar** dhe shoqëruar me (CD) dhe i firmosur sipas kërkesave të nenit 10 të VKM së mësipërme.

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) pas diskutimit dhe shqyrtimit nga ana teknike i rekomandoi KKDM, që dokumentacioni teknik nuk është i plotë për të vlerësuar në mënyrë të plotë përshtatshmërinë e zgjidhjeve të propozuara, si dhe garantimin e kushteve të qëndrueshmërisë dhe sigurisë së digës.

Pas diskutimeve të të gjithe antarëve të pranishëm, KKDM:

VENDOSI:

Të mos miratoj Projektin e paraqitur nga Bashkia Tepelenë, për "Rehabilitimin e diges së Turanit", për shkak të mungesave të konstatuara në dokumentacionin teknik të paraqitur si dhe mosplotësimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Ti kërkohet Bashkisë Tepelenë si shfrytëzuese e digës së Turanit, plotësimi dhe argumentimi teknik si më poshtë:

- Paraqitja e detyrës së projektimit dhe oponencës teknike.
- Rakordimin e studimeve gjeologjike, gjeoteknike, gjeofizike dhe sizmike.
- Rishikimin dhe argumentimin e parametrave të përdorur në llogaritjet e filtrimit dhe qëndrueshmërisë.
- Paraqitjen e analizave të plota të qëndrueshmërisë së skarpatave dhe të sigurisë së digës në gjendjen përfundimtare të rehabilituar.
- Plotësimin e zgjidhjeve teknike për rehabilitimin e ujëlëshuesit, kurorës, shkarkuesit dhe sistemimin e skarpatave.
- Paraqitjen e verifikimeve hidraulike dhe konstruktive për elementet përkatëse të veprës.
- Paraqitja e licencës së projektimit për digat/dambat
- Të parashikohet edhe instalimi i instrumentave matës të digës si:instrumenta për matjet gjeodezike dhe kapërderdhës për matjet e filtrimeve në biefin e poshtëm.

Administruesi i veprës të marrë masa për monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së digës deri në realizimin e ndërhyrjeve rehabilituese, me vëmendje të veçantë ndaj filtrimeve, deformimeve, gjendjes së ujëlëshuesit dhe ndryshimeve të nivelit të rezervuarit. Në rast të evidentimit të përkeqësimit të gjendjes ose të shenjave të rrezikut, të merren menjëherë masat përkatëse të sigurisë për digën e Turanit.

KKDM do të jetë e gatshme të shqyrtojë sërish projektin e rehabilitimit të Digës së Turanit, pas plotësimit të të gjitha mangësive të konstatuara dhe të evidentuara më sipër.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

Ju faleminderit për Mirëkuptimin

Me respekt,

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Ardian ISLAMI